



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KUKËS  
SEKRETARI

Nr. 162/2 Prot.

Kukës, më 16. 02. 2024

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Kukës

**Drejtuar:** Kryetarit të Bashkisë Kukës

Drejtorisë Shërbimit Social dhe Kujdesit Shoqërorë

Drejtorisë Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtorisë së Administrimit të Pyjeve

Drejtorisë së Arsmi Kulturës e Sportit

Policisë Bashkiake

~~Drejtorisë IT dhe Inovacionit~~

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, neni 56 pika 2 gërma a, neni 61 të “Rregullores së Organizimit dhe Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Kukës”, thërras mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Kukës me datë **23.02.2024**, ora **11:00**, në Sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak,

**RENDI I DITËS**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë **26.01.2024**.
2. **Projektvendim** “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6%, **Janar 2024**”.
3. **Projektvendim** “Për dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qira të pasurisë Nr. 2208, të llojit pyll (shkurre), pjesë të saj, konkretisht sipërfaqen prej 15 ha, pjesë e pasurisë në fshatin Kolsh, Njësia Administrative Kolsh, Bashkia Kukës. Fusha e përdorimit të pronës

që jepet me qira të jetë: “Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogenerator dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse)”.

4. **Projektvendim** “ Për dhënie me qira të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe prej 0.061 ha dhe 1.65 km rrugë për vendosjen e antenave të komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare Vodafone Albania sh.a”
5. **Projektvendim** “ Për miratimin e planit për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Kukës për vitin 2024”.
6. **Projektvendim** “ Për miratimin e shpërblimit për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike që fituan Medaljen e Artë në vitin shkollor **2022-2023**”.
7. **Projektvendim** “ “Për shtesën në listën e projekteve prioritare për vitin 2024, të projektit të zbatimit për objektin: Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza të fshatit Bardhoc I Ri, Njësia Administrative Tërthore”.

**Të ndryshme**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Albert MUJA**

